

NJOFTIM PËR SHPREHJE INTERESI PËR EKSPERTË TË JASHTËM

Në kuadër të procedurës së rekrutimit për pozicionin:

“Drejtor Drejtorie, Drejtorja e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit”

Bashkia Tepelenë kërkon të angazhojë ekspertë të jashtëm, me profil akademik dhe profesional të lartë, për asistencë në procesin e vlerësimit të kandidatëve, në përputhje me legjislacionin për shërbimin civil dhe rregullat e konkurrimit në administratën publike.

Ekspertët e përzgjedhur do të jenë pjesë e Komitetit të Pranimi për Lëvizje Paralele / Pranim në Shërbimin Civil, i cili do të përbëhet nga pedagogë të institucioneve të arsimit të lartë, drejtorë të përgjithshëm të administratës publike, si specialistë të fushës së planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Kriteret për ekspertin:

- Të zotërojë diplomë universitare në Arkitekturë, Inxhinieri Ndërtimi, Urbanistikë.
- Të ketë eksperiencë profesionale në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;
- Të ketë njohuri mbi legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, administratën publike dhe procedurat e shërbimit civil;
- Të ketë integritet profesional dhe paanshmëri në procesin e vlerësimit.

Detyrat kryesore:

- Marrja pjesë në procesin e vlerësimit të kandidatëve;
- Dhënia e mendimit profesional dhe teknik gjatë procedurës së konkurrimit;
- Vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale të kandidatëve sipas kritereve të përcaktuara.

Dokumentacioni i kërkuar:

- Kërkesë për shprehje interesi;
- Curriculum Vitae (CV);
- Kopje të diplomës dhe dokumenteve kualifikuese;
- Dokumentacion që vërteton eksperiencën profesionale.

Dokumentacioni dorëzohet pranë protokollit të Bashkisë Tepelenë.